Projekti “Certifikoni italishten tuaj. Gjuha për t’u përfshirë në shoqëri, për punën dhe nënshtetësinë”

Viti mësimor 2011/12

Shëndetësia dhe asistenca sociale

Tekste prezantimi në ppt

Slide 1

SHËNDETËSIA NË ITALI

Slide 2

ASISTENCA SHËNDETËSORE

Për të pasur të drejtë për asistencë shëndetësore është e nevojshme të regjistroheni pranë Shërbimit Shëndetësor Kombëtar

Ku?
Pranë ASL-it, agjencisë shëndetësore lokale

Kujdes
ASL-i ku bëni pjesë tregohet në lejen tuaj të qëndrimit

Slide 3

REGJISTRIMI PRANË ASL-it

Për t'u regjistruar pranë ASL-it dhe për të marrë kartën shëndetësore, nevojitet të merret me vete:
- dokumenti i identitetit
- kodi fiskal
- leja e qëndrimit
- vetë-dokumentimi i banesës ose shtëpisë

Kujdes
Nevojitet të shkoni pranë ASL-it për të zgjedhur mjekun e familjes dhe pediatrin për fëmijët

Slide 4

KARTA SHËNDETËSORE

Karta shëndetësore është rajonale

Kujdes
Në rast se transferoheni në Rajon tjetër, njoftoni ASL-in e vendit të banimit
Nëse është njoftuar ASL-i, mund të vazhdoni të shfrytëzoni të gjitha shërbimet shëndetësore (mjekun, pediatrin, medikamentet, spitalin, etj.)

Slide 5

ME KARTËN SHËNDETËSORE

Shtetasi ka të drejtën për:
- vizita në ambulancë
- vizita të specializuara
- vizita në shtëpi
- shtrim në spital
- vaksinime
- analiza gjaku
- radiografi, ekografi
- medikamente
- rehabilitim

Kujdes
Për disa vizita dhe medikamente nevojitet të paguhet "ticket"

Slide 6

KËSHILLA TË DOBISHME PËR SHËNDETIN E FËMIJËVE

Janë të detyrueshme vaksinimet kundër:

- difterisë
- tetanosit
- poliomielitit
- hepatitit B

Për informacione të tjera
– pyesni mjekun e familjes
– shkoni pranë ASL-it

Slide 7

URGJENCA

Në rast sëmundjeje të rëndë ose aksidenti:
- shkoni në spital tek Urgjenca
- ose telefononi numrin 118 për të thirrur ambulancën

Kujdes
Në urgjencë koha e pritjes varet nga serioziteti i gjendjes

Slide 8

PRITJA NË URGJENCË

Kodi i kuq
Gjendja shëndetësore shumë e rëndë: ka përparësi për vizitën mjekësore

Kodi i verdhë
Gjendja shëndetësore e rëndë: pritje e shkurtër për vizitën mjekësore

Kodi i gjelbër
Gjendja shëndetësore pak e rëndë: pritje e gjatë dhe vizitë pas të sëmurëve në gjendje më të rëndë,

Kodi i bardhë
Gjendja NUK është shqetësuese: pritje shumë e gjatë dhe vizitë pas të gjithë të sëmurëve të tjerë, Në disa raste paguhet "ticket"

Slide 9

SËMUNDJET E LEHTA

- dhimbje koke
- dhimbje dhëmbi
- dhimbje barku
- dhimbje stomaku
- kollë, ftohje …

Për sëmundjet e lehta
– shkoni në farmaci
– kërkoni këshillë nga farmacisti
– blini medikamentet

Kujdes
Farmacisti mund të japë vetëm ndonjë këshillë, sepse është mjeku i familjes që kuron sëmundjet

Slide 10

ASISTENCA SOCIALE NË ITALI

Slide 11

EKZISTOJNË SHUMË SHËRBIME SOCIALE PËR...

- të miturit (fëmijët dhe të rinjtë nën 18 vjeç)
- të moshuarit
- personat me aftësi të kufizuar
- të varfrit
- …

Kujdes
Shërbimet sociale ndryshojnë nga qyteti në qytet

Slide 12

INFORMACIONE MBI SHËRBIMET SOCIALE

Për informacione mbi shërbimet sociale të qytetit ku banoni
- pyesni në Komunë

Slide 13

DOKUMENTET PËR ASISTENCËN SOCIALE ...

Shtetasit e huaj kanë të njëjtat të drejta si italianët
POR për të përfituar asistencë sociale

shpesh duhet të paraqesin:
- vërtetimin e banimit
- lejen e KE-së për ata që kanë leje qëndrimi afatgjatë

Slide 14

VARFËRIA DHE ASISTENCA SOCIALE

I sëmuri që ka mjete të pakta ekonomike mund të përfitojë ndihmën e asistencës sociale nëse është:
- i verbër ose invalid civil
- grua e pamartuar shtatzënë ose me fëmijë të vegjël

Edhe familjet në vështirësi mund të marrin ndihma.
Shembuj
- për qiranë
- për mensën shkollore të fëmijëve
- ...

Slide 15

FJALORTH

Shërbimi Shëndetësor Kombëtar: sistemi publik i asistencës shëndetësore për të gjithë shtetasit
ASL: agjencia shëndetësore lokale që bën pjesë në Shërbimin Shëndetësor Kombëtar
Vaksinë: injektim që mbron nga disa sëmundje